

## Syllabusi i lëndës

**Lënda:** Kurani II

**Programi i studimit:** Teologji Islame

**Niveli;** Bachelor

**Numri i ECTS kredive:** 6

**Statusi i lëndës:** Obligative

**Kodi i lëndës:** 206

**Fondi i orëve:** 2+2

**Viti akademik:** 2026/2027

**Semestri:** IV-të

**Mësimdhënësi:** Dr. Fidan Xhelili

### Përmbajtja e shkurtër e lëndës

Lënda e Kuranit është një nga lëndët më të rëndësishme në FSI për faktin që Kurani është bazamenti themelor i Islamit .Në lëndën përkatëse përfshihen tri fusha kryesore:Nxënia përmendëshe pjesës- xhuzit të dytë të Kuranit. Leximi i drejtë me Kuran të hapur nga Kaptinat e ndryshme si dhe rregullat teorike të leximit të drejtë respektivisht Texhvidi .Lënda në fjalë është atraktive si dhe ka karakter interaktiv dhe shpirtëror

### Qëllimi i lëndës:

- Lidhja e studentit me librin e shenjtë Kuranin e madhërisëm , duke lexuar dhe mësuar përmendësh .
- Korrigjimi i studentit gjatë leximit të Kuranit të madhërisëm .
- Njohja teorike dhe praktike mbi rregullat e Texhvidit .
- Njohja e studentit me disa fjalë të panjohura që kalojnë gjatë recitimit.

### Rezultatet e pritura

- Avansimi i studentit në aspektin e leximit të Kuranit .
- Njohja e studentit me Texhvid në rrafshin teorik dhe praktik.

- Mësimi përmendësh i një sasive të konsiderueshme nga Kurani i madhërishtë konkretisht 20 faqe. (xhuzi i dytë)
- Studentit i mundëson të përshkruaj rregullat e leximit të drejtë të Kuranit të madhërishtë .
- Aftëson studentin që t'i aftësoj të tjerët me të njejtat kompetenca pas përfundimit në tërësi me të gjithë semestrat e tij.

### **Metodologjia e mësimdhënies:**

Mësimi do të zhvillohet në formë të ligjëratave, stimulimit të studentëve në diskutime interaktive, duke bërë pyetje dhe analiza në kuadër të ligjëratës së mbajtur. Po ashtu do të shfrytëzohen pajisjet e projektorëve për prezantimin e njohurive në formë të sllajdeve me programin Power Point. Po ashtu do të mbahen seminare dhe ese të ndryshme, të cilat do të prezantohen në mënyrë individuale por edhe grupore, dhe teste të vlerësimit. Dhe të tëra këto do të plotësohen me zbatimin e tyre në praktikë duke i implementuar në lexim-këndimin e studentëve para profesorit. Gjithashtu studentët kanë mundësi që gjatë përgatitjes së lëndës të kontaktojnë me profesorin dhe të marrin udhëzime me qëllim të arritjes së cilësisë dhe rezultateve në mësim dhe sukses të studentëve.

### **Përmbajtja e lëndës:**

#### **Java e parë:**

Njohje e studentëve me syllabusin dhe planprogramin e lëndës përgjatë semestrit, si dhe rregullat akademike të mirësjelljes e gjithashtu edhe standardet e vlerësimit. *Lexim:* Kaptina El-Enam fq 128-132, *Përmendësh* El-Bekare fq 22.

#### **Java e dytë:**

*Texhvid*; : Rregullat e Idgimit mutemathilejn, mutexhanisejn dhe mutekaribejn, llojet dhe specifikat e tyre.. *Përmendësh*; Kaptina El-Bekare fq 23. *Lexim*; Kaptina El-Enam fq 133-138.

**Java e tretë:** *Texhvid*; Vazhdim i tematikave të idgimit. Rregullat e veçanta të shqiptimit të shkronjës "Ra". *Përmendësh*; El-Bekare fq 24-25. *Lexim*; Kaptina El-Enam fq 139-145.

**Java e katërt:** *Texhvid*; Rregullat e veçanta të shqiptimit të shkronjës "RA".. *Lexim*: Kaptina El-Enam fq 146-150. *Përmendësh*: Kaptina El-Bekare fq 26

**Java e pestë:** *Texhvid*; Vazhdim i tematikës rreth shkronjës "RA".. *Lexim*; Kaptina El-Earaf fq 151-156. *Përmendësh*: Kaptina El-Bekare fq 27-28.

**Java e gjashtë** *Texhvid* Zgjatimet dhe llojet e tyre. *Lexim*: Kaptina El-Araf fq 157-162. *Përmendësh*; Kaptina El-Bekare fq 29.

**Java e shtatë:** *Texhvid*; Zgjatimet jo të natyrshme ose joburimore. *Lexim*; Kaptina El-Araf fq 163-168. *Përmendësh*; Kaptina El-Bekare fq 30-31.

**Java e tetë:** *Texhvid:* Zgjatimi i lidhjes së madhe. *Lexim;* Kaptina El-Araf fq 169-176. *Përmendësh:* Kaptina El-Bekare fq 32.

**Java e nëntë:** *Texhvid;* Zgjatimi i domosdoshëm i shkronjës. rastet, llojet dhe norma e tij. Mënyra e leximit të bashkëtingëlloreve simbolike në fillim të disa sureve *Lexim: Kaptina El-Enfal fq 177- 181. Përmendësh; Kaptina El-Bekare fq 33-34.*

### **Java e dhjetë:**

(Kolekfium)

**Java e njëmbëdhjetë** *Texhvid:*Zgjatimi për shkak të sukunit të rastit, format, llojet dhe normat e tij *Lexim:*Kaptina El-Enfal fq 182-186. *Përmendësh;* Kaptina El-Bekare fq 35.

**Java e dymbëdhjetë:** *Texhvid:* Takimi i më shumë shkaktarëve të zgjatimit, cilit i jepet prioritet? *Lexim:* Kaptina El-Enfal fq 187-192. *Përmendsh;* Kaptina El-Bekare fq 36-37.

**Java e trembëdhjetë:** *Lexim;* Kaptina Et-Tevbe fq 193-198. *Përmendësh;* Kaptina El-Bekare fq 38-39.

**Java e katërbëdhjetë:**. *Lexim;* Kaptina Et-Tevbe fq 199-204. *Përmendësh:* Kaptina El-Bekare 40-41.

**Java e pesëmbëdhjetë:** Përmbyllje e semestrit me një përsëritje gjithëpërfshirëse e diskutime interaktive.

### **Kriteriumi dhe komponentët e vlerësimit:**

Pjesëmarrje dhe angazhimi në ligjeratë 10%

Testi i parë 40%

Provimi final 50%

Total 100%

### **Literatura obliguese:**

1. Sllajdet e përgatitura nga Profesori i lëndës

### **Literatura shtesë- sugjeruese**

- 1- Emin Behrami, Shkenca e Texhvidit, Prishtinë 200
- 2- El-Munir fi ahkamit-texhvid- grup autorësh, botimi i 22-të, viti 2013, Jordani.